

# **Kurset për LLL**

## **Grupi i hartimit të kualifikimit:**

### **Anëtarët e grupit:**

Prof. Dr. Skender Muji

Prof.Dr. Bajram Berisha

Porf. Dr. Muhamet Kamberi

Prof. Asoc. Alltane Kryeziu

Prof. Dr. Arben Mehmeti

*Prishtinë*

## I – Përshkrimi i përgjithshëm

### **1. Grupi që do të përfshihet në këtë kualifikim**

- Kush përfshihet (grupet e synuara) në këtë kualifikim:
  - Te rinj që kanë mbaruar arsimin e mesëm të përgjithshëm ose profesional dhe janë interesuar të mësojnë rreth kulturave bujqësore, bimëve foragjere dhe fermave për rritjen e kafshëve
  - Persona që janë të papunë dhe janë të interesuar të mësojnë praktika të reja për prodhuesit e kulturave të përziera dhe kafshëve
  - Studentet që janë të interesuar të administrojnë njësi të vogla të ndërmarrjeve bujqësore ose ferma, planifikojnë, organizojnë dhe kryejnë operacione bujqësore
  - Të interesuarit për të fituar njohuri për të kultivuar bimë foragjere si dhe kultura të ndryshme të tjera, shtimin e kafshëve përmes shumëllojshmërisë së mbarështimit të tyre
  - Persona që zhvillojnë aktivitete të marketingut, shitjes dhe ose shpërndarjes së produkteve bujqësore – blegtorale.
- Kriteret hyrëse për këtë kualifikim:
  - Të drejtë aplikimi kanë të gjithë interesuarit për këtë kualifikim të cilët kanë shkollim paraprak (nga arsimi i mesëm dhe profesional)
  - Dinamikën e rrjedhës së procesit, provimin pranues, shpalljen e rezultatit preliminar, ankesat dhe shpalljen e rezultatit final në mënyrë të hollësishme i përcakton konkursi publik

### **2. Validimi i kualifikimit**

Kualifikimi validohet nga njesia për LLL, pran Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, Universiteti i Prishtinës.

### **3. Kohëzgjatja dhe kreditë**

Kualifikimi do të ketë një kohëzgjatje mesatare prej **1300** orësh mësimore, ku 1 orë mësimore = 45 minuta. Ky kualifikim ka gjithsej **65** kredi.

#### **4. Struktura e Kualifikimit**

Struktura e kualifikimit (modulet obligative dhe zgjedhore):

##### **Modulet obligative:**

- Kultivimi i bimëve foragjere
- Të ushqyerit e llojeve të ndryshme të kafshëve
- Marketingu, shitja dhe shpërndarja e produkteve bujqësore – blegtorale
- Mbrojtja e bimëve
- Përmirësimi gjenetikë i kafshëve
- Kontrolli i cilësisë së prodhimeve ushqimore
- Etologjia aplikative e kafshëve
- Rritja dhe menaxhimi i shpendëve
- Përdorimi dhe mirëmbajtja e mekanizmit bujqësor
- Mirëqenia e kafshëve

##### **Modulet zgjedhore:**

- Menaxhimi i mbeturinave
- Kafshët e shoqërimit
- Bletaria
- Rritja dhe menaxhimi i joripërtypsëve
- Pjelloria e tokës dhe plehërimi

- Numri i kandidatëve: 15/grup (2 grupe për 1 vit)

#### **5. Vlerësimi dhe Çertifikimi**

- Informatat relevante për metodat e vlerësimit të moduleve (vlerësimi formativ) dhe ai përfundimtar (sumativ): Vlerësime intermedier dhe finale, punë laboratorike dhe punë në terren, seminare, projekte individuale etj.
- Me përfundimin e suksesshëm të kualifikimi kandidatit do t'i jepet një certifikatë
- Qasja e vlerësimit teorik dhe praktik %: 40% - 60%

#### **II- Përmbajtja e Kualifikimit**

##### **1. Objektivat e përgjithshme të kualifikimit**

Në përfundim të këtij kualifikimi, kandidatët do të jenë të aftë të:

- Kuptojnë nocionet bazike lidhur me prodhuesit e kulturave të përziera dhe kafshëve
- Identifikojnë instrumente të ndryshme që shfrytëzohen në këtë sektor
- Përshkruajnë metodat e ndryshme të ruajtjes dhe menaxhimit të resurseve
- Diskutojnë çështje të ndryshme emergjente lidhur me tematikat e prodhuesve dhe sfidat më të cilat ballafaqohen
- Aplikojnë metoda të avancuar në hulumtime me këtë kualifikim dhe për module specifike
- Bëjnë ndërlidhje të aspekteve teorike dhe praktike

## 2. Modulet e kualifikimit

1	Kultivimi i bimëve foragjere	Nr. 1	100 orë mësimore 33.3 % Teori 50 % Praktikë 12.5 % Vlerësim 4.2 % tjera Kredi: 5	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kandidatet do të njohin mirë vetitë e përgjithshme të bimëve foragjere dhe mënyrat e kultivimit të llojeve të ndryshme</li> <li>2. Të njohin aplikimin e drejt dhe me kohë të të gjitha masave të përkujdesit dhe specifike agroteknike që aplikohen gjatë kultivimit</li> <li>3. Te kenë njohuri për arritjen e rendimenteve të larta si qëllim i fundit i kultivimit në prodhimtarinë e bimëve foragjere</li> </ol>
2	Të ushqyerit e llojeve të ndryshme të kafshëve	Nr. 2	100 orë mësimore 33.3 % Teori 50 % Praktikë 12.5 % Vlerësim 4.2 % tjera Kredi: 5	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Tregojnë aftësi teorike dhe praktike lidhur me të ushqyerit e llojeve dhe kategorive të ndryshme të kafshëve varësisht prej fazave të prodhimtarisë.</li> <li>2. Të jenë në gjendje të njohin përbërjen kimike të ushqimeve për kafshë, përpilimin e racione të balancuara dhe përshtatjen kërkesave të prodhimtarisë.</li> <li>3. Të formojnë opinionin e tyre lidhur me kërkesat dhe principet e përgjithshme të ushqyerit të kafshëve.</li> </ol>
3	Marketingu, shitja dhe shpërndarja e produkteve bujqësore – blegtorale	Nr. 3	100 orë mësimore 33.3 % Teori 50 % Praktikë 12.5 % Vlerësim 4.2 % tjera Kredi: 5	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kandidati identifikon atributuesit të sipërmarrësve në bujqësi dhe zbulon grupet e konsumatorëve të rëndësishme për idenë e biznesit;</li> <li>2. Analizon kërkesat dhe sjelljet e tyre</li> <li>3. Zgjidh qasjen e duhur për hulumtimin e tregut</li> <li>4. Vështrime në mendimin dhe vendimmarrjen e konsumatorëve</li> </ol>
4	Mbrojtja e bimëve	Nr. 4	100 orë mësimore 33.3 % Teori 50 % Praktikë 12.5 % Vlerësim 4.2 % tjera Kredi: 5	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kandidati do të ketë njohuri lidhur me sëmundjet, dëmtuesit dhe barojat e bimëve foragjere</li> <li>2. Kandidati do të jete në gjendje të identifikojnë sëmundjet dëmtuesit dhe barojat e bimëve foragjere</li> <li>3. Kandidati do të dijë se cilat janë sëmundjet, dëmtuesit dhe barojat e që shkaktojnë dëme ekonomike</li> </ol>

				4. Kandidati do të fitoj njohuri rreth aplikimit të masave adekuata për mbrojtjen e bimëve foragjere si dhe kohën dhe numrin e spërkatjeve.
5	Përmirësimi gjenetikë i kafshëve	Nr. 5		1.
6	Kontrolli i cilësisë së prodhimeve ushqimore	Nr. 6	100 orë mësimore 33.3 % Teori 50 % Praktikë 12.5 % Vlerësim 4.2 % tjera Kredi: 5	1. Kandidati do të përgatitet që të vlerësojnë dhe të zhvillojnë sisteme për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë. 2. Në mënyrë specifike, ata do të përvetësojnë njohuri teorike dhe praktike rreth identifikimit të parametrave të ndryshëm që ndikojnë në cilësinë e ushqimit. 3. Studentët do të përvetësojnë gjithashtu njohuri për aplikimin e masave, metodave dhe procedurave të kontrollit të cilësisë.
7	Etologjia aplikative e kafshëve	Nr. 7	100 orë mësimore 33.3 % Teori 50 % Praktikë 12.5 % Vlerësim 4.2 % tjera Kredi: 5	1. Kandidati do të njoh mënyrat e komunikimit midis kafshëve 2. Të kuptoj ndikimin e sjelljes në organizimin e jetës sociale 3. Njoh ndikimin e sjelljes së kafshëve në jetën e tyre 4. Të ndërlidh njohuritë e biologjisë filogjenetike dhe biologjisë së konservimit me sjelljen e kafshëve
8	Rritja dhe menaxhimi i shpendëve	Nr. 8	100 orë mësimore 33.3 % Teori 50 % Praktikë 12.5 % Vlerësim 4.2 % tjera Kredi: 5	1. Kandidati do të njohë rëndësinë së rritjes, kultivimit të shpendëve dhe qëndrueshmërinë e biznesit të shpendëve; 2. Të njoh kërkesat e shpendëve për kushtet e mbajtjes, madhësinë e fermës dhe lokacionin e ndërtimit të fermës; 3. Do të jetë në gjendje të njohë racat e shpendëve, fazat e prodhimit, vlerësimin e vezëve për çelje, fazat e inkubimit dhe cilësinë e zogjve njëditorë. 4. Do të dijë praktikat gjatë rritjes, të ushqyerit, masat parandaluese për mbrojtjen e shpendëve nga sëmundjet, përgatitjen e produkteve për treg dhe përpilimin e formave të ndryshme për mbajtjen e shënimeve të prodhimit.
9	Përdorimi dhe mirëmbajtja e mekanizmit bujqësor	Nr. 9	100 orë mësimore 33.3 % Teori 50 % Praktikë 12.5 % Vlerësim 4.2 % tjera Kredi: 5	1. Analizimi i çështjeve dhe kufizimeve të mëdha në inxhinieri bujqësore si dhe identifikon kufizimet lidhur me fuqinë dhe makinerinë bujqësore; 2. Identifikimi i elektrifikimit bujqësor, aplikimi; kuptojn sistemin e prodhimit të vogël dhe strukturën bujqësore

				<ol style="list-style-type: none"> <li>Kuptoni strukturën e ruajtjes dhe konservimit të tokës, ujit, pajisjet matëse, mjetet dhe pajisjet diagnostikuese</li> <li>Përmirësimi i efikasitetit në terren, përputhja e madhësisë dhe kapacitetit të makinës: kapacitetet teorike, efektive dhe aktuale</li> </ol>
10	Mirëqenia e kafshëve	Nr. 10	<p>100 orë mësimore  33.3 % Teori  50 % Praktikë  12.5 % Vlerësim  4.2 % tjera  Kredi: 5</p>	
11	Menaxhimi i mbeturinave	Nr. 11	<p>100 orë mësimore  33.3 % Teori  50 % Praktikë  12.5 % Vlerësim  4.2 % tjera  Kredi: 5</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Kandidatet identifikojnë problemet mjedisore të shkaktuara nga mbeturinat</li> <li>Kuptojnë rëndësinë e menaxhimit adekuat të mbeturinave</li> <li>Identifikojnë dhe njohin disa nga metodologjitë e deponimit dhe riciklimit të mbeturinave</li> <li>Integrojnë njohuritë paraprake nga biologjia dhe ekologjia në adresimin e çështjeve mjedisore që kanë të bëjnë me mbeturinat.</li> </ol>
12	Kafshët e shoqërimin	Nr. 12		
13	Bletaria	Nr. 13	<p>100 orë mësimore  33.3 % Teori  50 % Praktikë  12.5 % Vlerësim  4.2 % tjera  Kredi: 5</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Kandidatët do të fitojnë njohuri themelore mbi morfologjinë dhe fiziologjinë e bletëve dhe habitatin e tyre.</li> <li>Të kuptojnë rolin e bashkëpunimit të bletarisë me produktet bujqësore lokale, shërbimet e ekosistemit.</li> <li>Të kuptojnë rëndësinë e menaxhimit të drejtë dhe profesional të bletëve në mardhënie me kushtet klimatike sipas periudhave të vitit.</li> <li>Të kenë njohuri në identifikimin e sëmundjeve, parazitëve dhe dëmtuesëve të bletëve, trajtimin e tyre dhe mbajtjen nën kontrollë.</li> </ol>
14	Rritja dhe menaxhimi i joripërtypësve	Nr. 14	<p>100 orë mësimore  33.3 % Teori  50 % Praktikë  12.5 % Vlerësim  4.2 % tjera  Kredi: 5</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>Kandidati do të njohë rëndësisë së rritjes, kultivimit të derrave/kuajve dhe qëndrueshmërinë e biznesit me këto kafshë;</li> <li>Të njoh kërkesat e derrave/kuajve për kushtet e mbajtjes, madhësinë e fermës dhe lokacionin e ndërtimit të fermës;</li> <li>Do të jetë në gjendje të njohë racat e derrave/kuajve, fazat e rritjes, vlerësimin e trendit të rritjes dhe zhvillimit</li> <li>Do të dijë praktikat gjatë rritjes, të ushqyerit, masat parandaluese për mbrojtjen e derrave/kuajve nga sëmundjet, përpilimin e formave të ndryshme për mbajtjen e shënimeve të prodhimit.</li> </ol>

<b>15</b>	<b>Pjelloria e tokës dhe plehërimi</b>	15	100 orë mësimore 33.3 % Teori 50 % Praktikë 12.5 % Vlerësim 4.2 % tjera Kredi: 5	
-----------	--	----	---	--

**Modulet obligative:**

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe numri	Kultivimi i bimëve foragjere	Nr. 1
Qëllimi	Qëllimi i modulit është njohja praktikat e kultivimit të bimëve foragjere	
Kohëzgjatja e modulit dhe kreditë	100 orë mësimore, 5 kredi	
Kërkesat për qasje në modul	Shkollim paraparak (nga arsimi i mesëm dhe profesional)	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b> <b>1. RM1 (titulli):</b> Kandidatet do të njohin mirë vetitë e përgjithshme të bimëve dhe mënyrat e kultivimit të llojeve të ndryshme		
Përmbajtja	Kriteret e vlerësimit	Instrumentet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rëndësia e kultivimit të bimëve foragjere</li> <li>- Mënyrat e kultivimit</li> <li>- Kërkesat e bimëve foragjere gjatë procesit të kultivimit etj.</li> </ul>	Kandidati duhet: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të di rreth rëndësisë se kultivimit të bimëve foragjere</li> <li>- Të njoh bazën teorike të procesit të kultivimit</li> <li>- Të di rreth aspekteve praktike të makinerive të përdorura në proces kultivimit</li> <li>- Të i dijë kërkesat agroekologjike dhe mikroklimatike të bimëve foragjere për kultivim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime ;</li> <li>- Testime etj.</li> </ul>
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b> <b>1. RM2 (titulli):</b> Të njohin aplikimin e drejt dhe me kohë të të gjitha masave të përkujdesit dhe specifike agroteknike që aplikohen gjatë kultivimit të bimëve foragjere		
Përmbajtja	Kriteret e vlerësimit	Instrumentet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatitja e tokës për mbjelljen e bimëve foragjere</li> <li>- Mbjellja e bimëve foragjere</li> <li>- Masat e përkujdesit gjatë kultivimit të bimëve foragjere</li> </ul>	Kandidati duhet: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të kryej procedurat operative në përgatitje të tokës për mbjellje</li> <li>- Të përcjell fazat e zhvillimit të bimëve foragjere</li> <li>- Të i njoh teknikat e kultivimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b> <b>RM3 (titulli):</b> Te kenë njohuri për arritjen e rendimenteve të larta si qellim i fundit i kultivimit ne prodhimtarinë e bimëve foragjere		
Përmbajtja	Kriteret e vlerësimit	Instrumentet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përckatimi i zonave për</li> </ul>	Kandidati duhet:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i</li> </ul>



<p>kultivim</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Përgatija e bimëve foragjere për ushqim të kafshëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të zgjedhja e vendit e duhur ku do të kultivohen bimët foragjere</li> <li>- Të njoh praktikat e qendrueshme të kultivimit të bimëve foragjere</li> <li>- Të di rreth mënyrave të përgatijes së bimëve foragjere për të ushqyerit e kafshëve</li> </ul>	<p>një punë praktike apo një hulumtimi;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>
<p><b>Udhëzimet për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e kandidatëve</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ky modul duhet të përfshij komponentët kyçe në kultivimin e bimëve foragjere</li> </ul>	
<p><b>Baza materiale e domosdoshme</b></p>	<p>Per realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Salla ligjërimi</li> <li>- Laboratorë</li> <li>- Fusha të mbjellura me bimë foragjere etj.</li> <li>- Pajisje mobile etj.</li> </ul>	

PËRSHKRUESI I MODULIT		
<b>Titulli dhe numri</b>	<b>Të ushqyerit e llojeve të ndryshme të kafshëve</b>	Nr. 2
<b>Qëllimi</b>	<b>Moduli ka për ka për qëllim që pjesëmarrësve të iu ofroj njohuri të mjaftueshme teorike dhe praktike për mënyrën e të ushqyerit të kafshëve dhe përpilimin e racioneve të balancuara të llojeve të ndryshme të kafshëve në pikëpamje të gjitha kërkesave me lëndë ushqyese</b>	
<b>Kohëzgjatja e modulit dhe kreditë</b>	<b>100 orë mësimore, 5 kredi</b>	
<b>Kërkesat për qasje në modul</b>	<b>Shkollim paraprak (nga arsimi i mesëm dhe profesional)</b>	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
<b>RM1 (titulli):</b> Tregojnë aftësi teorike dhe praktike lidhur me të ushqyerit e llojeve dhe kategorive të ndryshme të kafshëve varësisht prej fazave të prodhimitarisë.		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit (performancës), njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Principet e përgjithshme të ushqyerit të ripërtypësve; Të ushqyerit e gjedheve, karakteristikat anatomike dhe fiziologjike të organeve të tretjes të gjedhit, proceset biokimike të zbrërthimit të lëndëve ushqyese në rumen.</li> <li>- Të ushqyerit e lopëve në bazë të ciklit prodhues, të ushqyerit e lopëve në periudhën e tharjes, të ushqyerit e lopëve në laktacion.</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të i njoh parimet e përgjithshme të ushqyerje se kafshëve</li> <li>- Të i njoh karakteristikat anatomike të organeve të tretjes</li> <li>- Të ketë njohuri rreth aparatit të tretjes</li> <li>- Të ketë njohuri rreth procese biokimike</li> <li>- Të përshkruaj ciklin e prodhues në bazë të të ushqyerit etj</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
<b>RM2 (titulli):</b> Të jenë në gjendje të njohin përbërjen kimike të ushqimeve për kafshë, përpilimin e racione të balancuara dhe përshtatjen kërkesave të prodhimitarisë.		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit (performancës) njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Racionet në të ushqyerit e gjedheve, të ushqyerit dimërorë dhe të ushqyerit verorë.</li> <li>- Marrëdhëniet në mes ushqimeve voluminoze dhe të koncentruara në racion, mundësia e shfrytëzimit të uresë në të ushqyerit e lopëve qumështore.</li> <li>- Të ushqyerit e viçave, vlera ushqyese dhe imunologjike e kulloshtrës, sistemet e të</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të tregoj rreth racioneve të të ushqyerit</li> <li>- Të bëjë lidhshmëri ne mes të ushqimeve voluminoze dhe te koncentruar</li> <li>- Të di rreth kërkesave për ushqim të kafshët</li> <li>- Të di rreth vlerave ushqyese të ushqimeve</li> <li>- Të ofroj njohuri kategori të ndryshme të kafshëve sa i përket të të ushqyerit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>

<p>ushqyerit të viçave. Të ushqyerit e kategorive të ndryshme të gjedhit për trashje.</p>		
<p>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit  <b>RM3</b> (titulli): Të formojnë opinionin e tyre lidhur me kërkesat dhe principet e përgjithshme të ushqyerit të kafshëve.</p>		
<p><b>Përmbajtja</b></p>	<p><b>Kriteret e vlerësimit (performancës)</b></p>	<p><b>Instrumentet e vlerësimit</b></p>
<p>- Njohurit e përgjithshme lidhur me kërkesat e të ushqyerit për llojeve të ndryshme të kafshëve:          Shpendëve          Deleve          Kuajve          Lepujve etj</p>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dijë lidhur me kërkesat e të ushqyerit për grupet e ndryshme të kafshëve:             <ul style="list-style-type: none"> <li>o Shpendëve</li> <li>o Deleve</li> <li>o Kuajve</li> <li>o Lepujve</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>
<p><b>Udhëzimet për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e kandidatëve</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ky modul synon ti aftësoj kandidatet me njohuri të përgjithshme lidhur me të ushqyerit e llojeve dhe kategorive të ndryshme të kafshëve varësisht prej fazave fiziologjike të kafshëve. Trajton tema të veçanta lidhur me ushqimet si : njohja me vlerat energjetike, proteinike, vitaminoze etj.</li> </ul>	
<p><b>Baza materiale e domosdoshme</b></p>	<p>Per realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Salla për ligjërime të pajisura me video-projektorë</li> <li>- Laboratorë</li> <li>- Vizita në terren etj</li> </ul>	

PËRSHKRUESI I MODULIT		
<b>Titulli dhe numri</b>	<b>Marketingu, distribuimi dhe shitja e produkteve bujqësore – blegtorale</b>	Nr. 3
<b>Qëllimi</b>	<b>Përmes këtij kursi pjesëmarrësit do të fitojnë njohuri për bizneset në fushën e bujqësisë.</b>	
<b>Kohëzgjatja e modulit dhe kreditë</b>	<b>100 orë mësimore, 5 kredi</b>	
<b>Kërkesat për qasje në modul</b>	<b>Shkollim paraprak (nga arsimiti i mesëm dhe profesional)</b>	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
<b>RM1 (titulli): Kandidati identifikon atributuesit të sipërmarrësve në bujqësi dhe zbulon grupet e konsumatorëve të rëndësishme për idenë e biznesit;</b>		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit (performancës), njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Kush janë bizneset?</li> <li>- Vendimi fillestar</li> <li>- Kuptimi i suksesit të biznesit: strategji, fat dhe politikë</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ti identifikoj bizneset</li> <li>- Të njoh proceset inciuese</li> <li>- Të përcaktoj grupet e konsumatorve</li> <li>- Të zhvilloj konceptet e suksesit në biznes</li> <li>- Të aplikojë strategji politike në ide biznesore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj.</li> </ul>
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
<b>RM2 (titulli): Analizon kërkesat dhe sjelljet e tyre</b>		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit (performancës) njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Financimi i biznesit</li> <li>- Bizneset e vogla dhe inovacionet</li> <li>- Ndërmarrje antisociale, jologjore dhe kriminale. Politika e ndërmarrjeve</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të ketë njohur rreth finacave</li> <li>- Të njoh aktet normative të funksionimit të firmave të vogla, ndërmarrjeve antisociale, jologjore etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
<b>RM3 (titulli): Zgjidhë qasjen e duhur për hulumtimin e tregut</b>		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit (performancës)</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Konkurrenca Globale e Qyteteve, Zhvillimi Rajonal i qyteteve</li> <li>- Inovacionet sociale, Njohuritë dhe rrjeti në qytetet e zgjuara Bizneset e qëndrueshme</li> <li>- Ndërmarrësia Institucionale dhe Planifikimi</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të ketë njohuri për zhvillimin e konkurrencave</li> <li>- Të zhvilloj ide inovative</li> <li>- Të krijoj dokumente zhvillimore</li> <li>- Të bëjë planifikime</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>

Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit		
<b>RM4</b> (titulli): Vështrime në mendimin dhe vendimmarrjen e konsumatorëve		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Studimet e rasteve të bujqësisë</li> <li>- Krahasimi i përdorimit të tokës dhe zhvillimi i qëndrueshë</li> <li>- Identifikimi i Funkcionalitetit të sistemeve bujqësore</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të zgjeroj format e hulumtimit</li> <li>- Të krahasoj raste studimi nga shembuj të ndryshëm në botë</li> <li>- Të identifikoj funksionet që i ofrojnë sistemet bujqësore</li> <li>- Të bëjë lidhshmëri në mes të popullsisë dhe tokës bujqësore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>
<b>Udhëzimet për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e kandidatëve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ky modul mundëson kandidatëve të kuptojnë biznesin, përkufizimet rreth ndërmarrësisë në fushën e bujqësisë, rolin e ndërmarrësisë në krijimin e bizneseve të vogla dhe të mesme, funksionin e tyre dhe rëndësinë e biznesit në ekonominë kombëtare, ekonominë e tregut etj.</li> </ul>	
<b>Baza materiale e domosdoshme</b>	<p>Per realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Salla për ligjërime të pajisura me video-projektorë</li> <li>- Laboratorë</li> <li>- Kompjuter etj.</li> </ul>	

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe numri	Mbrojtja e bimëve	Nr. 4
Qëllimi	Qëllimi i studimit të lëndës Mbrojtja e bimëve është që te njoftohen studentet me sëmundjet, dëmtuesit dhe barojat kryesore të bimëve foragjere, pastaj te njoftohen me simptomat qe shkaktojnë ato, biologjinë e sëmundjeve, insekteve dhe barojave si dhe masat për mbrojtjen e bimëve foragjere	
Kohëzgjatja e modulit dhe kreditë	100 orë mësimore, 5 kredi	
Kërkesat për qasje në modul	Shkollim paraprak (nga arsimi i mesëm dhe profesional)	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
RM1 (titulli): Kandidati do të ketë njohuri lidhur me sëmundjet, dëmtuesit dhe barojat e caktuara		
Përmbajtja	Kriteret e vlerësimit (performancës), njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat	Instrumentet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Koncepti për sëmundjet, dëmtuesit dhe barojat e bimëve dhe klasifikimi i tyre.</li> <li>- Përhapja e sëmundjeve, dëmtuesbe dhe barojave dhe veprimi i tyre në bimët foragjere</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të identifikoj sëmundjet, dëmtuesit dhe barojat kryesore të bimëve foragjere</li> <li>- Të bëjë klasifikimin e sëmundjeve, dëmtuesive dhe barojave</li> <li>- Të di rrugët e përhapjes së shkaktarëve të sëmundjeve, dëmtuesve dhe barojave</li> <li>- Të njoh veprimet e sëmundjeve, dëmtuesve dhe barojave tek bimët foragjere</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
RM2 (titulli): Kandidati do të jetë në gjendje të identifikojë sëmundjet, dëmtuesit dhe barojat tek bimët foragjere		
Përmbajtja	Kriteret e vlerësimit (performancës) njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat	Instrumentet e vlerësimit
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sëmundjet kryesore (blozene e misrit, blozen eelbit, urthin e grurit, fuzarizot etj.)</li> <li>- Dëmtuesit kryesor (ushunjezen e drithërave, krimbin e misrit, turigjtine e terfilit etj.)</li> <li>- Barojat kryesore (minuerin e bardhë, cirzen e arave, nenën e përveshur, tatullen etj.)</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të di për shkaktarët sëmundjeve, dëmtuesve dhe barojat</li> <li>- Të di për simptomat</li> <li>- Të ketë njohuri rreth efekteve të këtyre sëmundjeve të njeriu</li> <li>- Të sugjeroj masat për trajtim etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
RM3 (titulli): Kandidati do të dinë se cilat janë sëmundjet dëmtuesit dhe barojat që shkaktojnë dëme ekonomike		

<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit (performancës)</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sëmundjet kryesore (blozene e misrit, blozen eelbit, urthin e grurit, fuzarizot etj.)</li> <li>- Dëmtuesit kryesor (ushunjezen e drithërave, krimbin e misrit, turigjtine e terfilit etj.)</li> <li>- Baroajt kryesore (minuerin e bardhë, cirzen e arave, nenën e përveshur, tatullen etj.)</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të di për shkaktarët e këtyre sëmundjeve, dëmtuesve dhe barojave</li> <li>- Të di për simptomat, dëmet dhe determinimin e tyre</li> <li>- Të ketë njohuri rreth efekteve të këtyre sëmundjeve të njeriu</li> <li>- Të sugjeroj masat për trajtim dhe mbrojtje etj.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj.</li> </ul>
<p>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</p> <p><b>RM4</b> (titulli): Kandidati do të fitoj njohuri rreth aplikimit të masave adekuate për mbrojtje kundër këtyre sëmundjeve, dëmtuesve dhe barojave si dhe kohen dhe numrin e spërkatjeve</p>		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Aplikimi i pesticideve</li> <li>- Herbicideve</li> <li>- Fungicideve</li> <li>- Preparatet biologjike kundër sëmundjeve, dëmtuesve dhe barojave</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të identifikoj pesticide e nevojshme për trajtim</li> <li>- Të di jrrreth efekteve anësore të pesticideve</li> <li>- Të dij rreth menaxhimit të integruar të pesticideve</li> <li>- Të aplikoj metoda biologjike të mbrojtjes së bimëve nga dëmtuesit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj.</li> </ul>
<b>Udhëzimet për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e kandidatëve</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ky modul duhet të ofroj të dhëna specifike për mbrojtjen e bimëve nga dëmtuesit</li> </ul>	
<b>Baza materiale e domosdoshme</b>	<p>Për realizimin e modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Salla për ligjërime të pajisura me video-projektorë</li> <li>- Laboratorë</li> <li>- Substanca kimike</li> <li>- Mjete dhe pajisje gjatë punës praktike në fusha të kultivuara më bimë foragjere etj.</li> </ul>	

PËRSHKRUESI I MODULIT		
<b>Titulli dhe numri</b>	<b>Përmirësimi gjenetik i kafshëve</b>	Nr. 5
<b>Qëllimi</b>	<b>Qëllimi i modulit/lëndës është që pas përfundimit pjesëmarrësit të arrijnë të njohin dhe interpretojnë objektivat e përmirësimit gjenetik të kafshëve. Kjo është fushë shkencore merret me përmirësimin gjenetik të kafshëve shtëpiake me qëllim të rritjes së produktivitetit, por edhe veçorive tjera me interes.</b>	
<b>Kohëzgjatja e modulit dhe kreditë</b>	<b>100 orë mësimore, 5 kredi</b>	
<b>Kërkesat për qasje në modul</b>	<b>Shkollim paraparak (nga arsimi i mesëm dhe profesional)</b>	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
<b>RM1 (titulli): Kandidatet duhet të përvetsojnë metodat dhe teknikat për përmirësimin gjenetik të kafshëve të ndryshme shtëpiake.</b>		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Baza gjenetike e kafshëve.</li> <li>- Bazat molekulare të trashëgimisë.</li> <li>- Përmirësimi gjenetik i kafshëve</li> <li>- Metodatat/teknikat e përmirësimit gjenetik dhe seleksionimit të kafshëve</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të ketë njohuri për konceptet bazike në gjenetikë</li> <li>- Të di principet e bazave të biologjisë molekulare</li> <li>- Të njoh mënyrat, metodat/teknikat e përmirësimit gjenetik të kafshëve</li> <li>- Të di metodat bazike për seleksionimin e racave të shtazëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një pune praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim;</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
<b>RM2 (titulli): Kandidati do të mësojë mënyrën e krijimit dhe mirëmbajtjes së racave dhe do të njoh burimet e variabilitetit gjenetik.</b>		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Përhapja e materialit gjenetik të kafshëve;</li> <li>- Koncepti i krijimit/përmirësimit të racave të kafshëve;</li> <li>- Konservimi dhe organizimi i bankës së gjeneve;</li> <li>- Burimet e variacionit gjenetik;</li> <li>- Mutacionet, rekombinimi i gjeneve, transferi i gjeneve.</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të di rreth përhapjes së materialit gjenetik të kafshëve</li> <li>- Të përshkruaj krijimin/përmirësimin e racave</li> <li>- Të di rreth konservimit të materialit gjenetikë</li> <li>- Të sqaroj burimet e variacionit gjenetike dhe shkaqet e mutacioneve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Demonstrime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
<b>RM3 (titulli): Kandidati duhet të njohin në tersi procesin trashëgimise, heritabilitetit, ibridingut dhe të heterozisit.</b>		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>



<ul style="list-style-type: none"> <li>- Trashëgimia dhe ndryshueshmëria e tipareve cilësore dhe sasiore.</li> <li>- Trashëgimia poligenike.</li> <li>- Heritabiliteti.</li> <li>- Rëndësia e heterozisit</li> <li>- Rëndësia e inbridingut.</li> <li>-</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të përshkruaj dhe sqaroj shkaktaret e ndryshimeve cilësore dhe sasiore në trashëgim</li> <li>- Të përshkruaj praktikisht heritabilitetin, heterozisin dhe procesin e inbridingut</li> <li>-</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>
<p>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit  <b>RM4</b> (titulli): Kandidati duhet te zotrojne njohuri te mjaftueshme rreth Bioteknologjise bashkëkohore deri te organizmat-shtazët e modifikuarra gjenetikisht (OMGj) dhe klonimi.</p>		
<p><b>Përmbajtja</b></p>	<p><b>Kriteret e vlerësimit</b></p>	<p><b>Instrumentet e vlerësimit</b></p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Procesi i domestikimit te kafshëve;</li> <li>- Bioteknologjia e riprodhimit te shtazëve (IA, IVF, ET etj);</li> <li>- Prodhimi i shtazëve transgjenike (OMGj), strategjitë, qëllimi dhe fushat e aplikimit;</li> <li>- Klonimi i shtazeve-llojet;</li> <li>- Bioteknologjia dhe etika.</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Te përshkruaj dhe sqaroj procesin e domestikimit te shtazëve;</li> <li>- Të përshkruaj dhe sqaroj metodat e bioteknologjise se riprodhimit;</li> <li>- Të përshkruaj metodat bazike te prodhimit te shtazëve transgjenike (OMGj);</li> <li>- Te sqaroj metodat kryesore te klonimit te shtazëve</li> <li>- Te interpretoj rregullat bazike te etikes ne bioteknologji.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj</li> </ul>
<p><b>Udhëzimet për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e kandidatëve</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ky modul duhet të ofroj të dhëna specifike për përmirësimin gjenetikë të shtazëve, metodat e kryqëzimeve, burimeve të variabilitetit, bioteknologjine shtazore etj</li> </ul>	
<p><b>Baza materiale e domosdoshme</b></p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Salla për ligjërime të pajisura me video-projektorë</li> <li>- Laboratorë</li> <li>- Kompjuterë</li> <li>- etj</li> </ul>	

<b>PËRSHKRUESI I MODULIT</b>		
<b>Titulli dhe numri</b>	<b>Kontrolli i cilësisë së prodhimeve ushqimore</b>	<b>Nr. 6</b>
<b>Qëllimi</b>	Qëllimi i modulit është fitimi i njohurive dhe familjarizimi i studentëve me parimet e sistemeve të menaxhimit për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë në industrinë ushqimore.	
<b>Kohëzgjatja e modulit dhe kreditë</b>	1 semestër, 5 kredi	
<b>Kërkesat për qasje në modul</b>	Shkollim paraprak (nga arsimi i mesëm dhe profesional)	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
<b>RM1 (titulli):</b> Kandidatët do të përgatiten që të vlerësojnë dhe të zhvillojnë sisteme për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë së prodhimeve ushqimore.		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit (performancës), njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Rëndësia e sigurimit dhe kontrollit të cilësisë në industrinë ushqimore;</li> <li>- Dimensionet, standardet, përcaktimi i cilësisë;</li> <li>- Programet dhe sistemet e cilësisë në industrinë ushqimore.</li> </ul>	Kandidati duhet: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të sqaroj rëndësinë e kontrollit në industrinë ushqimore;</li> <li>- Të njoh standardet e përcaktimit të cilësisë;</li> <li>- Të aplikoj programe dhe sisteme të avancuara në funksion të sigurimit të cilësisë në industrinë ushqimore.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkriminjepunepraktikeapojnjehulumti mi;</li> <li>- Tëshprehurit me gojë;</li> <li>- Tëshprehurit me shkrim;</li> <li>- Prezantime;</li> <li>- Testimeetj.</li> </ul>
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit:</b>		
<b>RM2 (titulli):</b> Në mënyrë specifike, studentët do të përvetësojnë njohuri teorike dhe praktike rreth identifikimit të treguesve të ndryshëm që ndikojnë në cilësinë e ushqimit.		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit (performancës) njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Standardet e sistemit të cilësisë;</li> <li>- Standardet e sistemit të cilësisë ISO;</li> <li>- Programet GMP (praktikat e mira të përpunimit);</li> <li>- Programet HACCP;</li> <li>- Dokumentet: SOP, GMO, QCA, PSM, të pajisjeve etj.</li> </ul>	Kandidati duhet: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të zbatoj standardet e cilësisë;</li> <li>- Të dij përparësitë e sistemit ISO;</li> <li>- Të aplikoj programet GMP dhe HACCP;</li> <li>- Të përdorë dokumentet: SOP, GMO, QCA, PSM.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkriminjepunepraktikeapojnjehulumti mi;</li> <li>- Tëshprehurit me gojë;</li> <li>- Tëshprehurit me shkrim;</li> <li>- Prezantime;</li> <li>- Testimeetj.</li> </ul>
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit:</b>		
<b>RM3 (titulli):</b> Studentët do të përvetësojnë gjithashtu njohuri për aplikimin e masave, metodave dhe procedurave të kontrollit të cilësisë.		

<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit (performancës)</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Auditimet e përpunimit: kontrolli i operacioneve të përpunimit;</li> <li>- Auditimet GMP dhe auditimet e cilësisë së prodhimit;</li> <li>- Metodatat statistikore për kontrollin e cilësisë në industrinë ushqimore.</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të sqaroj proceset e auditimit;</li> <li>- Të dij të zbatoj auditimet për GMP;</li> <li>- Të përdorë metodatat statistikore për kontrollin e cilësisë në industrinë ushqimore;</li> <li>- Të zbatoj programe të avancuara dhe softwer.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkriminjepunepraktikeapojhulumti mi;</li> <li>- Tëshprehurit me gojë;</li> <li>- Tëshprehurit me shkrim;</li> <li>- Prezantime;</li> <li>- Testimeetj.</li> </ul>
<b>Udhëzimet për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e kandidatëve</b>	<p>Ky modul duhet të jetë një përshkrim gjithëpërfshirës rreth sigurimit të cilësisë duke filluar nga konceptet për të vazhduar me zbatimin praktik të menaxhimit të cilësisë.</p>	
<b>Baza materiale e domosdoshme</b>	<p>Për realizimin në mënyrë të përshtatshme të modulit, është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Salla për ligjërime të pajisura me video-projektorë;</li> <li>- Reparte për përpunimin e prodhimeve ushqimore;</li> <li>- Laboratorë për kontrollin e prodhimeve ushqimore;</li> <li>- Kompjuter etj.</li> </ul>	

PËRSHKRUESI I MODULIT		
<b>Titulli dhe numri</b>	<b>Etologjia aplikative e kafshëve</b>	Nr. 7
<b>Qëllimi</b>	Ky modul ka për qëllim zhvillimin e njohurive rreth Etologjisë aplikative të kafshëve, komunikimit dhe ndërtimit të strukturave sociale si dhe në mënyrë që të përmirësoj efikasitetin e fermës dhe kontrollin e saj. Etologjia aplikative është term i përgjithshëm për mënyrën e menaxhimit të fermës me metoda të ndryshme që aplikohen për të mbajtur një fermë produktive dhe fitimprurëse duke i njohur sjelljet e kafshëve në mënyrë që të shfrytëzohet potenciali gjenetik prodhues të kafshëve.	
<b>Kohëzgjatja e modulit dhe kreditë</b>	100 orë mësimore, 5 kredi	
<b>Kërkesat për qasje në modul</b>	Shkollim paraprak (nga arsimi i mesëm dhe profesional)	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
<b>RM1 (titulli):</b> Kandidati do të njoh mënyrat e komunikimit ndërmjet kafshëve		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit (përformancës), njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Aspekti fiziologjik i sjelljes tek kafshët</li> <li>- Aspekti gjenetik i sjelljes</li> <li>- Të mësuarit tek kafshët</li> <li>- Komunikimi tek kafshët</li> </ul>	Kandidati duhet: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të pasqyroj aspektet fiziologjike të sjelljes së kafshëve</li> <li>- Të tregoj për gjenetikën e sjelljes</li> <li>- Të sqaroj mënyrën e të mësuarit të kafshët</li> <li>- Të tregoj llojet e komunikimit tek kafshët</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj.</li> </ul>
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
<b>RM2 (titulli):</b> Të kuptoj ndikimin e sjelljes në organizimin e jetës sociale		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit (përformancës) njohuritë, shkathtësitë dhe kompetencat</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sjellja sociale dhe hierarkitë tek kafshët</li> <li>- Territorialiteti</li> <li>- Sjellja riprodhuese</li> <li>- Përkujdesja prindëror</li> </ul>	Kandidati duhet: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dijë për sjelljen prindërore të kafshëve</li> <li>- Të dijë për kujdesinë për pasardhës</li> <li>- Të shpjegon pse disa nga kafshët kujdesen jashtëzakonisht shumë për të vegjlit e tyre.</li> <li>- Të dijë për mënyrat e riprodhimit të kafshëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj.</li> </ul>
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
<b>RM3 (titulli):</b> Njohin ndikimin e sjelljes së kafshëve në jetën e kafshëve		

<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit (përformancës)</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mekanizmat e vendimmarrjes</li> <li>- Vetjakësia dhe altruizmi</li> <li>- Çrregullimet e sjelljes, Stresi mirëqenia e kafshëve</li> <li>- Strategjitë alternative</li> <li>- Ndërlidhja e njeriut dhe kafshëve</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të dijë cilët janë mekanizmat e vendimmarrjes të kafshët</li> <li>- Të sqaroj altruizmin</li> <li>- Të tregoj strategji alternative rreth sjelljes së kafshëve</li> <li>- Të pasqyrojë lidhje ndërmjet sjelljes dhe evolucionit .</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj.</li> </ul>
<p>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit  <b>RM4 (titulli):</b> Të ndërlidhin njohuritë e biologjisë filogjenetike dhe biologjisë së sjelljes së kafshëve</p>		
<b>Përmbajtja</b>	<b>Kriteret e vlerësimit</b>	<b>Instrumentet e vlerësimit</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sjellja e gjedheve dhe ripërtpësve tjerë</li> <li>- Sjellja e derrave</li> <li>- Sjellja e Shpendëve</li> <li>- Sjellja e derrave</li> <li>- Sjellja e kuajve</li> <li>- Sjellja e qenve dhe maceve</li> </ul>	<p>Kandidati duhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të tregoj çka e shkakton evolucionin e sjelljes së kafshëve</li> <li>- Të njohin faktorët kryesor që ndikojnë në sjelljet e kafshëve, duke përfshirë ata të mjedisit të jashtëm, faktorët e brendshëm, faktorët gjenetik</li> <li>- Të dijë për sjelljen e kafshëve të caktuara.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Raporti me shkrim i një punë praktike apo një hulumtimi;</li> <li>- Të shprehurit me gojë;</li> <li>- Të shprehurit me shkrim;</li> <li>- Prezantime</li> <li>- Testime etj.</li> </ul>
<p><b>Udhëzimet për zbatimin e modulit dhe për vlerësimin e kandidatëve</b></p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ky modul ka të bëjë me ligjshmëritë dhe konceptet e sjelljes tek kafshët, mënyrat e të mësuarit tek kafshët, ndikimin e sjelljes në të ushqyer, riprodhim, përkujdesje për të vegjlit, përkatësinë grupore si dhe aspektet fiziologjike dhe psikologjike të sjelljes.</li> </ul>	
<p><b>Baza materiale e domosdoshme</b></p>	<p>Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kompjuterët,</li> <li>- Video Projektori,</li> <li>- Tabela të mençura</li> <li>- Mjetet dhe Pajisjet për vëzhgim të faunës në natyrë</li> </ul>	

PËRSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe numri	Rritja dhe Menaxhimi i Shpendëve	Nr. 8
Qëllimi	Qëllimi i modulit është t'ju ofrojë pjesëmarrësve të gjitha njohuritë dhe aftësitë që ju nevojiten për të rritur shpendët për mish dhe vezë dhe për të menaxhuar një biznes komercial të shpendëve	
Kohëzgjatja e modulit dhe kreditë	100 orë mësimore, 5 kredi	
Kërkesat për qasje në modul	Shkollim paraprak (nga arsimi i mesëm dhe profesional)	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit</b>		
2. RM1 (titulli): Kandidatet do të njohin mirë rëndësinë e mbajtjes së shpendëve, mënyrat e rritjes dhe kultivimit të tyre si dhe ekonominë e mbajtjes së shpendëve		
Përmbajtja	Kriteret e vlerësimit	Instrumentet e vlerësimit
